

VENDIM
Nr.670, datë 29.7.2015

**PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN PËR KRYERJEN E
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR REALIZIMIN E KONKURSIT TË
PROJEKTIMIT PËR HARTIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE
DERI PËR 26 BASHKI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban për kryerjen e procedurës së prokurimit për realizimin e konkursit të projektimit për hartimin e planeve të përgjithshme vendore deri për 26 bashki, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Fondi prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh për përballimin e pjesshëm të shpenzimeve, për vitin 2015, për realizimin e procedurave të prokurimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban për vitin 2015.

3. Pjesa tjetër e fondeve prej 530 000 000 (pesëqind e tridhjetë milionë) lekësh të përballohet nga buxheti i shtetit për vitin 2016. Kjo vlerë të parashikohet në buxhetin e Ministrisë së Zhvillimit Urban për vitin 2016.

4. Ministria e Zhvillimit Urban të fillojë procedurat e prokurimit sipas pikës 1, të këtij vendimi, dhe, përpara lidhjes së kontratës për realizimin e konkursit të projektimit për hartimin e planeve, të marrë miratimin e njësisë të qeverisjes vendore dhe të lidhë aktmarrëveshjen përkatëse. Lidhja e aktmarrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe bashkisë për caktimin e kushteve dhe të drejtave e të detyrimeve midis palëve është kusht për lidhjen e kontratës për hartimin e planeve vendore nga kjo ministri.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban dhe bashkitë, sipas listës bashkëlidhur vendimit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E BASHKIVE

- | | |
|----------------|------------------|
| 1) Dibër | 14) Konispol |
| 2) Durrës | 15) Krujë |
| 3) Gjirokastrë | 16) Kurbin |
| 4) Korçë | 17) Librazhd |
| 5) Kukës | 18) Përrenjas |
| 6) Lezhë | 19) Pogradec |
| 7) Shkodër | 20) Poliçan |
| 8) Tiranë | 21) Rrogozhinë |
| 9) Vlorë | 22) Sarandë |
| 10) Cërrik | 23) Shijak |
| 11) Divjakë | 24) Skrapar |
| 12) Himarë | 25) Urë-vajguore |
| 13) Kavajë | 26) Vorë |